



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 197/9 Prot  
mbledhja nr. 14/2018

Shkodër, më 23. 11.2018

**NJOFTIM**

për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

**Të nderuar këshilltarë,**

Në mbështetje të nenit 53 pika 2, pika 4; nenit 56 pika 2 shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33 pika 1 shkronja "a" të Rregullores së Këshillit, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, ditën e **Marte, datë 4 Dhjetor 2018, ora 16:00**, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për disa ndryshime në VKB nr. 1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Shkodër", të ndryshuar.
2. Pr/ Vendim: "Për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51, datë 14.04.2009 "Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtëshme shtetërore që kërkohen për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër", për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr. 421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut Shkodër të Shkodrës, të ndryshuar", sipas lidhjes 1, me nr rendor 17-18-19-22-23, sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtëshme shtetërore, bashkëlidhur" (pikë e shtyrë nga mbledhja e kaluar).

**Grafiku i mbledhjeve të komisioneve**

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i çështjeve ligjore	E Hënë	3.12.2018	10:00
2	Komisioni i buxhetit dhe aseteve publike	E Hënë	3.12.2018	11:00

Duke ju falenderuar,

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**